

VENDIM
Nr.1296, datë 29.12.2009

PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR.189, DATË 21.2.2008 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE E TË PROCEDURAVE TË
BASHKËRENDIMIT TË INFORMACIONIT, NDËRMJET MINISTRISË SË DREJTËSISË
DHE INSTITUCIONEVE TË TJERA PËRGJEGJËSE PËR SHQYRTIMIN E KËRKESAVE
PËR DËMSHPËRBLIM TË ISH-TË DËNUARVE POLITIKË TË REGJIMIT KOMUNIST, SI
DHE TË LLOJIT TË PËRGJEGJËSISË PËR ÇDO KËRKESË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 11 të ligjit nr.9831, datë 12.11.2007 “Për dëmshpërblimin e ish-të dënuarve politikë të regjimit komunist”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.189, datë 21.2.2008 të Këshillit të Ministrave, bëhen këto shtesa:

1. Pas nënndarjes “iii” të pikës 3, shtohet nënndarja “iv”, me këtë përmbajtje:

“iv. Për shqyrtimin e drejtpërdrejtë të kërkesave të paraqitura nga ish-të dënuarit politikë të regjimit komunist, të mbetur gjallë, Ministri i Drejtësisë dhe institucionet e përmendura në pikën 1 veprojnë menjëherë, pavarësisht afateve të përcaktuara në nënndarjet “i” dhe “ii” të pikës 3.”.

2. Pas nënndarjes “iii” të pikës 4, shtohet nënndarja “iv”, me këtë përmbajtje:

“iv. Për shqyrtimin e bashkërenduar të kërkesave të paraqitura nga ish-të dënuarit politikë të regjimit komunist, të mbetur gjallë, Ministri i Drejtësisë dhe institucionet e përmendura në pikën 1 veprojnë menjëherë, pavarësisht afateve të përcaktuara në nënndarjet “i” dhe “ii” të pikës 4.”.

3. Pas pikës 5 shtohen pika 5/1 e 5/2, me këtë përmbajtje:

“5/1. Ministri i Drejtësisë identifikon listën e ish-të dënuarve politikë të regjimit komunist, të mbetur gjallë, të cilën ia përcjell Ministrisë së Brendshme, Ministrisë së Mbrojtjes, Shërbimit Informativ të Shtetit e Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave të Shtetit.

5/2. Institucionet e përmendura në pikën 1 të këtij vendimi, lidhin memorandum bashkëpunimi ndërmjet tyre, për përshpejtimin e procedurave dhe të afateve të shqyrtimit të drejtpërdrejtë e të bashkërenduar të kërkesave të ish-të dënuarve politikë të regjimit komunist, të mbetur gjallë, si dhe të komunikimit zyrtar ndërmjet tyre.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha